Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikime
Nacionalni Autoritet za Kvalifikac
National Qualification Authority

Numër: 01/677
Datë: 08.12.2021

Këshilli Drejtues i Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve - kanë shqyrtuar ankesën Nr.01/553 të datës 02.11.2021 të parashtruar nga Institucioni Getting Competent, me adresë: Rr. Tring Smajli Nr.25/3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, kundër vendimit të Këshillit Drejtues të AKK-së Nr.01/470, të datës 13.10.2021, duke vepruar në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe, Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve qe ofrojnë kualifikime ne Kosove, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2021 dhe 07.12.2021 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** ankesa Nr.01/553, e datës 02.11.2021, e parashtruar nga institucioni Getting Competent.

2. **Mbetet** në fuqi vendimi Nr.01/470, i datës 13.10.2021, i Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duke u bazuar në kërkesën e institucionit "Getting Competent", me adresë: Rr. Tring Smajli Nr.25/3, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për validim dhe akreditim të institucioni si dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimeve, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, në mbledhjen e mbajtur me datë 13.10.2021 duke vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore ka nxjerr vendimin Nr.01/470, me të cilin vendim ka vendosur që refuzohet akreditimi i institucionit "Getting

Competent", për kualifikimet: 1. Instruktor/Mësimdhënës për të Rritur, si dhe 2. Trajner në Kompani.

Institucioni Getting Competent vendimin Nr.01/470, të datës 13.10.2021 të Këshillit Drejtues të AKK-së e ka pranuar me datë 19.10.2021.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.01/470 të datës 13.10.2021 të Këshillit Drejtues të AKK-së, bazuar në dispozitat ligjore, me datë 02.11.2021 parashtron ankesën me numër protokolli Nr.01/553 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Administrimi i provave: Këshilli Drejtues i AKK-së për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Vendimi Nr.01/470, i datës 13.10.2021, i Këshillit Drejtues të AKK-së; Ankesën me numër protokolli 01/553 të datës 02.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në AKK; Vendimi Nr.01/470, i datës 13.10.2021, i Këshillit Drejtues; Kopjen e protokollit ku dëshmohet data e pranimit të vendimit të kontestuar të KD-së; Kërkesa Nr.01/660, e datës 01.12.2021, nga AKK, drejtuar eksperteve vlerësues lidhur me ankesën e institucionit Getting Competent Emali zyrtar i datës 02.12.2021, nga ekspertët vlerësues ku janë parashtruar qëndrimet e eksperteve vlerësues lidhur me ankesën e institucionit Getting Competent;.

Këshilli Drejtues i AKK-së, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga institucioni Getting Competent është e ***pabazuar, sepse:***

Këshilli Drejtues i AKK-së, shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit i cili ka parashtruar ankesë kundër vendimit Nr.01/470 të datës 13.10.2021 të KD-së së AKK-së.

Pretendimet e dhëna në ankesën e parashtruar nga institucioni Getting Competent lidhur me refuzimin e akreditimit, janë çështje profesionale, rrjedhimisht nga kjo është e pamundur që personat që nuk e njohin këtë fushë të japin vlerësime lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë, duke u bazuar në ketë Këshilli Drejtues i AKK , në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2021 me votat e te gjithë anëtarëve prezent ka vendosur që lidhur me ankesën e institucionit Getting Competent Nr.01/553, të datës 02.11.2021 që:

1. Të kërkoj nga ekspertët vlerësues që kanë qenë të angazhuar nga AKK për "Getting Competent", që të njëjtit të japin arsyetim me shkrim lidhur me dëshmitë/pretendimet e ankuesit ne ankesën e parashtruara me Nr.01/553 në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.
2. Ekspertet vlerësues, mendimin profesional në formë të shkruar detyrohen që ta japin në afat kohor prej 48 orëve nga momenti i pranimit të kërkesës.

Këshilli Drejtues i AKK-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2021, me votat e të gjitha anëtarëve prezent, ka vendosur që pas pranimit të mendimit të ekspertëve vlerësues lidhur me ankesën e institucionit Getting Competent, për të njëjtin të votojnë në përputhje me nenin 41 të Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ekspertët vlerësues me datë 02.12.2021 përmes emalit zyrtar kanë dhënë mendimin profesional lidhur me pretendimet ankimore të institucionit Getting Competent, ku kanë theksuar se: "Referuar kërkesës së pranuar me 01.12.2021 nga ana juaj, paneli i ekspertëve, ri konfirmon edhe njëherë se, mbetet pranë mendimit përfundimtar rekomandues për KD /AKK, të dhënë në raportet e akreditimit dhe validimit për institucionin "Getting Competent".
Vlerësimi dhe mendimi përfundimtar i panelit të ekspertëve është mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar nga ana e institucionit "Getting Competent" me aplikacion, dokumentet shtesë të dorëzuara sipas afateve të përcaktuara nga AKK dhe në veçanti në të gjeturat dhe konstatimet e nxjerra nga vizita dhe takimet e realizuara në institucion me menaxhmentin dhe stafin e trajnerëve me datë 23.07.2021. Paneli i ekspertëve konsideron se të gjitha sqarimet e nevojshme dhe të gjeturat për institucionin në fjalë, janë paraqitur në raportet përfundimtare të akreditimit dhe validimit, të dorëzuara në AKK".

Këshilli Drejtues i AKK-së mbështetur në mendimin e eksperteve vlerësues të dhënë pas parashtrimit të ankesës së institucionit Getting Competent vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit Drejtues të AKK-së nuk është i ligjshëm mund të parashtroj padi në Gjykatën Kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucionit Getting Competent, dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK